



Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

Nr. 06-32699/2024

Klinë, datë: 30.08.2024

## PROCESVERBAL

**Nga dëgjim i katërt publik buxhetor për buxhetin e vitit 2025 të Komunës së Klinës, me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatit Përçevë, datë 16.08.2024, ora 18:30, SHFMU "Xhafer Gashi", Përçevë.**

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 15/09/2024 në emalin [vlora.tafili@rks-gov.net](mailto:vlora.tafili@rks-gov.net) ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen na takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i draft buxhetit i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike. Para të pranishmëve është prezantuar draft buxheti edhe në formatin elektronik në tabelat e mençura.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuara.

Takimi ka nisur në ora 18:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtori i Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Enver Berisha, këshilltarja e Kuvendit Komunal Klinë, Blerta Gashi, anëtarë të grupit punues si dhe banorë të zonave të lartcekura.

**Nga qytetarët morën pjesë 16 persona, prej të cilëve 1 grua dhe 15 burra.**

*Shtojca 1 – Fotografi nga dëgjim i pestë publik buxhetor për buxhetin e vitit 2025 të Komunës së Klinës, me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatit Përçevë, datë 16.08.2024, ora 18:30, SHFMU “Xhafer Gashi”, Përçevë.*



**Takimi u hap nga moderatori, Mirsad Dakaj, i cili hapi takimin: “Përshëndetje të nderuar të pranishëm!**

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Financa Publike dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë të hapur në Komuna, sot ne po hapim ciklin e dëgjimeve buxhetore për draft buxhetin e komunës së Klinës për vitin 2025, i cili është një proces shumë i rëndësishëm dhe thelbësor për t'i përcaktuar prioritetet e komunës për vitin e ardhshëm, për t'i pranuar kërkesat e juaja e të cilat grupi punues për draft buxhet do t'i shqyrtojë dhe analizojë me kujdes.

Në këtë takim jemi këtu bashkë me kryetarin e komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtori i Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, Enver Berisha, drejtori i Urbanizmit, Enver Berisha dhe anëtarë të grupit punues.

Dua të theksoj se komuna e Klinës është vlerësuar nga organizata joqeveritare, si DEMOS-i, e institucione të tjera, si komuna që ka pasur raportin më të mirë në Republikën e Kosovës të cikleve të dëgjimeve buxhetore në vitet e fundit për respektimin në përpikëri të dispozitat ligjore dhe është shembull për komunat e tjera. Me insistim të kryetarit jemi duke u angazhua që rezultatin e mirë që e kemi pasur vitin e kaluar me vazhdu edhe këtë vit dhe me krijua një praktikë të punës transparente dhe llogaridhënëse.

Duke e pasur për bazë këtë, ne si grup punues nuk kemi ndryshu shumë metodën e punës nga viti i kaluar. Në koordinim me kryetarin kemi hartua planin e punës, sikurse vitin e kaluar, ne kemi planifikuar t'i mbajmë 10 dëgjime buxhetore në lokalitete të ndryshme dhe po ashtu jemi të hapur t'i pranojmë kërkesat e sugjerimet edhe në formë elektronike deri me datën 30 gusht, ndërsa në fund, duke i respektuar edhe kornizën ligjore, draft-buxheti do të miratohet në kuvendin e komunës.

Para se me ia kalu fjalën kryetarit, kisha kërku nga ju që me u nënshkru në listën e pjesëmarrësve, sepse është një nga obligimet që dalin nga Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur.

Po ashtu edhe për kërkesat e miratuara të qytetarëve, ku këtë vit vetëm në KAB janë të miratuara rreth 90% të kërkesave e synojmë që e njëjta përqindje të jetë edhe në Draft-Buxhet.

Megjithëse ne kemi planifikuar t'i mbajmë takimet në disa lokalitete, kërkesat nuk duhet të kufizohen.

**Të pranishmit u njoftuan nga moderatori se për qëllime të dokumentimit të këtij takimi do hartohet procesverbali dhe komuna do publikoj video dhe fotografi nga ky takim.**

Të gjithë të pranishmit dhanë pajtimin për regjistrimin e takimit dhe publikimin e imazheve nga ky takim.

*Shtojca 2 – Fotografi nga dëgjimi i pestë buxhetor gjatë moderimit, i cili vazhdoi sipas agjendë së planifikuar të dëgjimit buxhetor.*



*Pas përfundimit të fjalimit të moderatorit fjala ju dha kryetarit të komunës.*

**Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:** “Përshëndetje të nderuar të pranishëm, faleminderit shumë për prezencën në këtë takim.

Jemi në takimin e katërt me radhë këtu në Përçevë. Sivjet, njëjtë si për Kornizën Afatmesme Buxhetor 2025 – 2027, e kemi përpilua një agjendë mjaftë të ngjeshur prej njëmbëdhjetë takimeve në mënyrë që të jemi sa me afër qytetarëve.

Këto dëgjime që po mbajmë në fshatrat tona janë një mundësi e jashtëzakonshme për të dëgjuar zërin e qytetarëve dhe për t'i përfshirë kërkesat dhe nevojat e tyre në planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. Bashkëpunimi ynë i ngushtë me komunitetin është thelbësor për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Përfshirja juaj aktive na ndihmon të ndërtojmë politika të qëndrueshme dhe të drejta, duke synuar një të ardhme më të mirë për të gjithë ne. Vizioni ynë është që asnjë kërkesë të mos mbetet pa u shqyrtuar, sepse suksesi i përbashkët nis me bashkëpunimin dhe dialogun e hapur këtu në mesin tuaj. Gjithsesi që unë më vete kam edhe anëtarët e grupi punues edhe çdo informatë, kërkesë, sugjerim, ide nëpërmjet tyre kur të hartojnë raporti do i japim kaheje dhe përgjigje.

Kur kam vendosë më e mbajt një takim të veçantë vetëm me banorët e fshatit Përçevë e kam kuptuar nevojën me qenë këtu sepse këtu ende nuk kemi kompletuar infrastrukturën e nevojshme me rrugë, kanalizim, trotuar e ndriçim. E që sot kemi me i nda bashkë prioritetet e vitit 2025 e që Përçeva të hyjë në hartën e Komunës së Klinës për investime. Ne kemi investime sivjet në vlerë 30 mijë euro, mendojmë ti drejtojmë në investimin e një rrugë për të shkolla. Unë nuk do të ndalem më shumë, ja kaloj fjalën drejtorit të Urbanizmit dhe Mbrojtjes

së Mjedisit, Enver Berisha që me na njoftua më shumë rreth Draft-Buxhetit të vitit 2025, e pastaj fjala është e juaja për projektet dhe nevojat. Ju faleminderit edhe njëherë!”

*Pas fjalës së kryetarit, fjala ju dha drejtorit të Urbanizmit, Enver Berishës.*

**Drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Enver Berisha:** “Përshëndetje të nderuar të pranishëm, faleminderit shumë për prezencën në këtë takim.

Në mungesë të drejtorit të Financave do të bëjë para jush një prezantim apo përmbledhje të shkurtër të darft-buxhetit të vitit 2025, të cilin e keni para jush në kopje fizike po ashtu do e paraqesim edhe në tabelën digjitale.

Buxheti i Komunës së Klinës për vitin 2025 është gjithsej, i planifikuar në total prej 16,168,653.00, i cili krahasuar më vitin 2024 është afërsisht 2 milion euro më shumë, i cili ka qenë 14,648,717.00. Nga buxheti i vitit 2025, ajo shumë është e ndarë në këto burime; Granti i përgjithshëm me rreth 6,571,819.00; Granti specifik i arsimit me rreth 5,953,349.00; Granti i shëndetësisë me rreth 1,897,981.00, Të hyrat vetanake me rreth 1,495,504.00; Financimi për shërbimet rezidenciale me rreth 250,000.00, të cilat në japin në total pra 16,168,653.00.

Ndërsa, buxheti i komunës së Klinës sipas kategorive të shpenzimeve për periudhën 2025 – 2027, është i ndarë në të hyrat totale komunale me rreth 16,168,653.00, siç e thamë edhe më herët, të hyrat vetanake me rreth 1,495,504.00 edhe këtë e theksuam me lart po ashtu, Grantet dhe transferet qeveritare me rreth 14,673,149.00, Pagat dhe mëditjet me rreth 8,800,000.00, Subvencionet më rreth 800,000.00, si dhe ajo që po besojë që juve ju intereson më së shumti e që janë Investimet Kapital, kanë një buxhet prej 4,498,653.00. E për projektet kapitale do të bisedojmë bashkërisht. Siç e shihni në dokumentin fizik të buxhetit të cilin e keni përpara, ne si komunë e kemi hartuar një listë të prioriteteve për vitin 2025, po që të cilën mund të ndryshohet apo plotësohet deri ky buxhet të prezantohet në kuvend për tu miratuar.

Unë si drejtorë i urbanizmit do të ju njoftojë edhe me disa nga projektet më të rëndësishme që janë duke u ekzekutuar e që janë fundërruesi për furnizim me ujë të pijes, në vlerë afër një milion euro, rregullimi i shtratit të lumit “Klina”, me infrastrukturë përcjellëse për këmbësor dhe biçikletat, ka ndriçim modern dhe pushimore.

Ndërtimi shtegut nga qendra e qytetit, sheshi “Ndue Përlleshi”, deri tek udhëkryqi Pejë-Prishtinë, i cili shteg ka po ashtu infrastrukturë përcjellëse për këmbësor dhe biçikletat, ka ndriçim modern, pushimore dhe gjelbërim. Një projekt i tillë e kemi në fazën përfundimtare është po ashtu rregullimi i liqenit akumulues për ujin e pijes, ku ky liqen ka argjinaturë të rregulluar në të dyja anët, ndërsa njëra anë ka infrastrukturë rekreative.

Unë nuk po zgjatem më shumë, jam këtu për çdo përgjigje, kërkesë, informacion apo ndonjë rekomandim që keni.

Ju falënderoj edhe njëherë!”

**Mirsad Dakaj:** “Faleminderit drejtor,

Atëherë, qytetarë fjala tani është të ju. Ashtu edhe siç e theksova në fillim, për shkak të procesverbalit ju lutem kur të merrni fjalën të thoni emrin, mbiemrin edhe kërkesa juaj ta ketë adresën e specifikuar, mundësisht. Urdhëroni ?”

*Pas fjalës së Mirsadit, fjala ju dha banorëve pjesëmarrës.*

**Beg Gashi, banorë i fshatit Përçevë:** “Përshëndetje kryetar, drejtorë Berisha dhe ju të nderuar të pranishëm. Faleminderit që sot jeni në Përçevë!

Përçeva si fshat ka nevojë të madhe për investime siç e ceket edhe ju kryetar. Janë kryer disa punime, disa asfaltime të rrugicave edhe një pjesë e vogël e rrjetit të ndriçimit publik, mirëpo shpresojë që do të jemi pjesë e planifikimeve të buxhetit për vitin e ardhshëm.

Unë po shpalosi dy kërkesa për buxhetim, **e para është shtrimi i rrugëve fushore më zhavorr**, si dhe **e dyta kërkesë është për riparimin e rrugëve**. Ju faleminderit shumë nëse i merrni në konsideratë!”

*Përgjigjet kryetari.*

**Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:** “Faleminderit shumë Beg,

E vlerësojë se dy kërkesat janë të domosdoshme për juve banorët dhe që të dy çështjet e ngritura janë pjesë e prioriteteve të komunës për vitin 2025. Desha të njoftojë se drejtorja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka kontratën për mirëmbajtjen e kanaleve dhe rrugëve fushore andaj do e adresoj kërkesën tënde tek drejtori përkatës, sepse këto kërkesa nuk ka nevojë të përfshihen në buxhet. Ne jemi në fazën e prokurimit publik si: “Furnizim dhe shtrim me zhavorr për riparim të rrugëve lokale dhe rrugëve fushore si dhe shërbime të tjera”, për momentin nuk po më kujtohet vlera mirëpo kërkesat e tilla i rregullojmë sipas kësaj kontrate.

*Pas fjalës së kryetarit, fjala ju dha banorëve të tjerë pjesëmarrës më radhë.*

**Arife Krasniqi, banore e fshatit dhe drejtoreshë e SHFMU “Xhafer Gashi”, Përçevë:** “Përshëndetje kryetar, drejtorë dhe gjithë juve të pranishmëve.

Unë si banore e fshatit Përçevë, njëherësh jam edhe drejtoreshë e kësaj shkolle ku po e mbajmë takimin sot “Xhafer Gashi”. Shkolla siç e shihni është në gjendje të mirë, janë bërë disa investime, së fundmi jemi pajisur edhe me tabelë të mençur. Ajo që më së shumti kemi nevojë e që po e paraqes si kërkesë për buxhetin e vitit 2025 është **ndërtimi i palestrës së sportit për shkollën “Xhafer Gashi”**. Ju faleminderit edhe njëherë!”

*Përgjigjet kryetari.*

**Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:** “Faleminderit shumë e nderuara drejtoreshë,

Shkollën “Xhafer Gashi”, e kam vizituar mjaft shpesh edhe e kam parë nga afër gjendjen. Secila shkollë në komunën e Klinës ka nevojë për investime të mëdha në aspektin e krijimit të kushteve për aktivitete sportive. Një vlerë të madhe të investimeve që kërkon një palestër me kushte të nevojshme dhe moderne e kam pa mundur me e realizua me një buxhet çfarë e kemi. Mirëpo, do ti shohë mundësit nëpërmjet bashkëpunimeve me institucionet qendrore apo ministritë e linjës.

**Mirsad Dakaj:** “Faleminderit kryetar dhe ju drejtoreshë znj. Krasniqi,

A ka dikush tjetër që dëshiron të merr fjalën për ndonjë kërkesë apo rekomandim?”

**Metë Gashi, banorë i fshatit Përçevë:** “Përshëndetje kryetar, faleminderit që sot jeni në Përçevë!

Ashtu siç tha edhe bashkëvendësi im Begi, kemi nevojë për riparim të rrugëve, e kërkesë në veçanti e shtojë **riparimin e rrugës kryesore nga gropat**. Ju faleminderit shumë nëse e regjistroni si kërkesë!”

*Fjala më radhë ju dha banorit Sami Gashi*

**Sami Gashi, banorë i fshatit Përçevë:** “Përshëndetje kryetar, drejtorë dhe gjithë juve të pranishmëve. Kryetar ka pasur ndriçim nëpër disa lagje mirëpo do të doja shumë sipas mundësive buxhetore si dhe po e shtojë si kërkesë që vitin e ardhshëm me e bë **shtrirjen e ndriçim publik 300 – 400 metra në rrugën “Tahir Kllaudra”**. Ju faleminderit shumë!”

*Përgjigjet kryetari.*

**Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:** “Faleminderit shumë Sami, sa i përkite kërkesës tënde, jemi mundu shumë që mos e me e pas asnjë fshat pa ndriçim publik, sidomos në rrugën kryesore të fshatit.

Pasi në të gjitha fshatrat ka ndriçim në rrugën kryesore, tani kemi fillua edhe me e degëzua nëpër lagje e rrugica të fshatit. Projekte të tilla kemi çdo vit që ndajmë fonde buxhetore. Andaj kërkesa të tilla janë të mirëseardhura sepse drejtoria për Shërbime Publike dhe kemi në planifikim buxhetor projektin “Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik”, në shumën prej 220 mijë euro.

**Mirsad Dakaj:** “Faleminderit kryetar,

A ka dikush tjetër që dëshiron të merr fjalën për ndonjë kërkesë apo rekomandim?”

Nëse jo, atëherë e shpalli të mbyllur takimin pas gjithë këtij diskutimi, ne si grup punues bashkë me kryetarin e komunës do të vazhdojmë në takimet e radhës nesër në Shtupel.

Gjithashtu, ju njoftojë se agenda e dëgjimeve është mjaft e ngjeshur dhe nëse dikush nga banorët që nuk ka qenë i pranishëm këtu, mund të jetë pjesë e takimeve të tjera siç janë:

Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Budisalc, Zllakuqan, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë, Rudicë, Videjë, Jagodë, Bërkovë, Krushevë dhe fshatrat e tjera, datë 19.08.2024, ora 19:00, vendi SHFMU “Atë Shtjefën Gjeçovi”, Zllakuqan.

Dëgjim publik me temë “Prioritetet e grave të komunës së Klinës, personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e tjera të marginalizuara”, datë 21.08.2024, ora 13:00, vendi SHFMU “Ismet Rraci”, Klinë.

Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus banorët e fshatrave Gjurgjevik i Madh, Jashanicë, Dush i Vogël, Siqevë, Dobërdol dhe fshatrat e tjera, datë 21.08.2024, ora 18:00, vendi SHFMU “Tre Dëshmorët”, Jashanicë.

Dëgjim publik me banorët e komunës së Klinës, me fokus bujqit, fermerët, kultivuesit dhe afaristët që operojnë në Klinë, tema e diskutimit “Projektet investive në zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë”, datë 22.08.2024, ora 17:00, vendi Salla e Kuvendit Komunal.

Dëgjim i përgjithshëm me banorët e komunës së Klinës, datë 25.08.2024, ora 17:00, vendi Salla e Kuvendit Komunal.

Për të gjitha këto takime ju kisha lut ta vizitoni web faqen zyrtare të komunës së Klinës po edhe rrjetin social Facebook për ma shumë detaje, apo edhe të kontaktoni me email zyrtaren Vlora Tafili; [vlora.tafili@rks-gov.net](mailto:vlora.tafili@rks-gov.net).

Koment, pyetje, sugjerimet e kërkesa e sotme që janë regjistruar në procesverbal, do të trajton në raportin final të dëgjimeve e më pas ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të kuvendit komunal para miratimit të buxhetit. Po që të cilin do ta gjeni të publikuar në web faqen zyrtare e aty mundeni me i pa secili prej juve që ka kontribuar përgjigjen edhe statusin e kërkesave.

Mirëmbetshi!”.

**Takimi u mbyll në ora 19:22.**

*Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.*

|        |    |
|--------|----|
| Gra    | 1  |
| Burra  | 15 |
| Totali | 16 |

Procesmbajtësja,  
Vlora Tafili

